

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Zenel Leku , anëtarë kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në Prishtinë– Distrikti në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.J., punëtor i të njëjtit, kundër të paditurit F.I. nga fshati ..., Komuna e Malishevës, për kompensim demi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevës, C.nr.77/2009 i datës 03.07.2014, në seancën jo publike të mbajtur më datë 16.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin si të bazuar të ankesës së paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në Prishtinë– Distrikti në Gjakovë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr.77/2009 i datës 03.07.2014, në pikën II të dispozitivit në pjesën e kërkespadiës lidhur me shpenzimet procedurale si dhe pikën III të dispozitivit të të njëjtit aktgjykim, dhe lënda për këtë pjesë të kërkespadiës i kthehet në rigjykim dhe vendosje Gjykatës së shkallës së parë.

II. Pika I e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe pika II e dispozitivit të të njëjtit aktgjykim në pjesën e kërkespadiës për kompensimin e dëmit dhe kamatën ligjore, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë më aktgjykimin e ankimuar C.nr.77/2009 i datës 03.07.2014, ka vendosur:

I.PJESËRISHT APROVOHET kërkespadija e paditësit KEK- u distrikt në Gjakovë si e bazuar.

II.Detyrohet e paditura F.I. nga fshati ..., që paditësit KEK-ut Prishtinë, tani me seli në Gjakovë, në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 501.12 euro, me kamat ligjore si për mjetet e afatizuara në bankë, si dhe shpenzimet procedurale përkatsisht taksat gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumën prej 15.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi.

III. Refuzohet kërkespadija e paditësit mbi shumën e kërkuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur paditësi duke e goditur pikën III të dispozitivit, dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së shkallës së dytë që ta anuloj aktgjykimin e goditur në pjesën refuzuese të tij, ta ndryshoj atë dhe ta

aprovovj kërkespadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, apo ta kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), dhe gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, me kërkesën që gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të propozuara, të bie aktgjykim në të cilin do të obligohet i padituri që paditësit t'ia paguajë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 9,105.79 €, me kamatë ligjore duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive, si dhe të obligohet edhe në pagesën e shpenzimeve të procedurës të cilat do të shkaktohen.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën sipas propozimit të palëve ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, me vlerësimin e të cilave ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, ku edhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se me provat e administruara nuk është kontestues fakti se punëtorët e të paditurës me rastin e daljes në vend me datë 20.08.2008 kanë konstatuar se i padituri duke mos pasur njehsor elektrike ka qenë duke e shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike përmes lidhjes së drejtpërdrejtë në shtyllë me kablo 4 X 16 mm, ku llogaritur sipas Procedurave për Llogaritje të Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike, sipas vlerësimit të bërë nga paditësi demi i shkaktuar ka kapur vlerën prej 9,105.79 euro, shumë kjo e kërkuar edhe sipas padisë se ushtruar, me çka nën rrethanën e tillë për gjykatën e shkallës së parë është bërë jokontestuese baza e kërkespadisë.

Sa i përket lartësisë së kërkespadisë Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se sipas propozimit të palës së paditur, si prove ka nxjerrë dhe administruar ekspertizën e ekspertit të elektros M.GJ., të cilës edhe ja ka falë besimin e plotë, në bazë të se cilës është vërtetuar se fatura e rikthimit të humbjeve në emër të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike lidhur me pajisjet elektrike të cilat i padituri i ka shfrytëzuar në kioskën e tij në kohëzgjatje prej 12 muajsh, bazuar në nenin 13 të Rregullores për Procedurën e Identifikimit dhe Parandalimit të Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike kap shumë prej 501.12 euro, me çka i padituri në kuptim të dispozitës së nenit 154 të LMD-së, është i detyruar që paditësit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar sipas gjetjeve të ekspertit të elektros, ku nga Gjykata edhe është vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkespadisë, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, duke arsyetuar se në bazë të ekspertizës së ekspertit të elektros nuk është vërtetuar se i padituri, paditësit ti këtë shkaktuar dëm mbi shumën e gjykuar prej 501.12 euro, me çka pjesën tjetër të kërkespadisë mbi shumën e gjykuar edhe e ka refuzuar si të pabazë.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke e vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka gjetur se qëndrimi dhe përfundimi juridike i gjykatës se shkallës së parë lidhur me pjesën refuzuese të kërkespadiisë se paditësit është i pabazuar dhe pa mbështetje ligjore, pasi që lidhur me këtë pjesë të kërkespadiisë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku për rrjedhojë ka pasur edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

Po që se i referohemi arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar, rezulton se gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sa i përket lartësisë së demit të gjykuar besimin del te ja ketë falur në tërësi ekspertizës se ekspertit të elektros M.GJ., me vlerësimin e të cilës ekspertizë gjykata e shkallës së dytë konstaton se i njëjti ekspert mendimin e tij profesional e ka dhënë duke u bazuar ne Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, e nxjerrë me 21 Korrik 2009 nga këtu paditësi KEK sh.a në Prishtinë, e cila ishte aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike.

Sipas vlerësimit të gjykatës se shkallës së dytë mendimi profesional i dhënë nga eksperti i elektros i cili është bazuar ne Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, e nxjerrë me 21 Korrik 2009 nga këtu paditësi KEK sh.a në Prishtinë, nuk korrespondon me provat nga shkresat e lëndës për shkakun se ne bazë te procesverbalit te paditëses i datës 20.08.2008, qartë konstatohet se i padituri ne shfrytëzimin e pa autorizuar te energjisë elektrike nga punëtorët e paditësit është hasur me datën 20.08.2008.

Nën rrethanën e tillë, rezulton se mendimi profesional i ekspertit të elektros është bazuar ne një akt normativ i cili nuk ka qenë ne zbatim ne kohën kur i padituri është zënë duke e shfrytëzuar ne mënyrë te pa autorizuar energjinë elektrike, me çka në situatën e tillë gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të mendimit profesional te ekspertit të elektros, edhe pa propozim të palëve, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ne kuptim të nenit 366 të LPK ka pasur për detyrim ligjor që ne seance të ftonte ekspertin më qëllim që i njëjti të sqarohet se pse mendimin e tij profesional e ka mbështetur në Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, i nxjerrë me 21 Korrik 2009, e jo me aktet normative te cilat kanë qenë ne zbatim në kohën kur është konstatuar se i padituri është duke e shfrytëzuar në mënyrë te pa autorizuar energjinë elektrike, aq me tepër kur për gjykatën e shkallës së parë do duhej te ishte fakt notor se ky akt normativ i nxjerrë nga paditësi në asnjë rrethanë nuk mund te ketë fuqi prapavepruese dhe te zbatohet edhe për rastet e keqpërdorimit të energjisë elektrike të cilat kanë mundur te ndodhin para se ky akt te hynte ne fuqi.

Mbi bazën e shkeljes se konstatuar si me lartë, ka mbetur pa u vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendja faktike sa i përket lartësisë se demit të shkaktuar paditësit, kur për rrjedhojë ka pasur edhe zbatimin e gabuar të se drejtës material, për të cilat shkaqe aktgjykimi i ankimuar në pjesën e goditur me ankesë u dashtë që të prishet dhe lënda për këtë pjesë ti kthehet Gjykatës se shkallës së parë ne gjykim dhe rivendosje , pasi që nuk pati kushte që aktgjykimi i ankimuar në pjesën e goditur të ndryshohet nga ana e gjykatës se shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës se parë ne kuptim te gjetjeve te konstatuara si me lartë nga ana e kësaj gjykate, ne ri procedurë udhëzohet që edhe pa propozim te palëve duke u kujdesuar sipas detyrës zyrtare ne seancë të ftoj ekspertit nga lëmi i elektros që i njëjti te sqarohet se ne bazë të cilës rrethanë apo fakt , mendimin e tij profesional e ka bazuar ne Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të

Energjisë Elektrike, i nxjerrë nga paditësi me 21 Korrik 2009, dhe pastaj m'varësisht prej sqarimeve apo plotësimeve të bëra nga eksperti ne mendimin e tij të dhënë, dhe vlerësimin të gjykatës lidhur me besueshmërinë e mendimit të tij profesional, gjykata sipas propozimit të palëve të nxjerrë dhe administroj prova ne drejtim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sa i përket lartësisë se kërkesëpadisë lidhur me pjesën për të cilën lënda është kthyer ne rigjykim, ku pastaj përmes zbatimit të normave të së drejtës materiale të ligjit i cili ka qenë ne fuqi ne kohën e krijimit të raportit detyrimor në mes ndërgjygjësve të bie një vendim të drejtë i cili do të ketë mbështetje ne provat shkresore dhe ne ligj.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe ne pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësit, pa u lëshuar fare ne ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore në një pjesë u dashtë qe të prishet dhe gjykatës së shkallës së parë ti kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate ne procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet te vendos me rastin e marrjes se vendimit përfundimtar, duke pasur suksesin e palëve ne procedurë dhe kush ju ka dhënë shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Pika I e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe pika II e dispozitivit të te njëjtit aktgjykim ne pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit dhe kamatën ligjore nuk është shqyrtuar nga ana e kësaj gjykate, për shkak se aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë nuk është goditur nga pala ankuese.

Nga te cekurat me lartë, e ne mbështetje te 195.1 pika c) dhe d), e lidhur me nenin 200 te Ligjit te Procedurës Kontestimore (LPK), u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac. nr. 4717/14, më datë 16.10.2018

Kryetari i kolegjit,
Qerim Ademaj, d.v